

Sektor i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të neneve 31 dhe 37 të Rregullores së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në lidhje me zbatimin e nenit 415 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për procedurë penale, në seancën e mbajtur më 07.12.2021, nxori:

K O N K L U Z I O N

Kur gjykata e shkallës së parë nga provat e nxjerra ka përcaktuar se i akuzuari gjatë kryerjes së veprës ka qenë i ngacmuar me sjellje të veçantë fyese apo të vrazhdë të të dëmtuarit, gjykata mundet që ta plotësojë përshkrimin e ngjarjes juridike penale në kumtimin e aktgjykimit, me theksimin e fakteve dhe rrethanave se “kryerësi”, ka qenë i ngacmuar me sjellje të veçantë fyese apo të vrazhdë të të dëmtuarit, si fakte ekzistimi i të cilave varet zbatimi i dispozitës së nenit 130 paragrafi 3 të Kodit penal, me atë nuk tejkalohet akuza.

Sektor i veprave penale